



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:171149

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05475385

C.nr.764/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.K, M.K dhe P.M, të cilët i përfaqëson avokati Z.H nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 10,549.98 euro, jashtë seancës, me datë 20.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses M.K.

II. APROVOHET PJESRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve B.K dhe P.M.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses B.K, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.07.2018, e deri me datën 31.12.2022, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 29.16 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 84.51 euro x 54 muaj, t'ia paguaj shumën prej 4,563.54 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 27.07.2021 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses M.K, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.07.2018, e deri me datën 31.12.2022, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 54 muaj, t'ia paguaj shumën prej 2,988.50 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 27.07.2021 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit P.M, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.09.2020, e deri me datën 31.12.2022, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 28 muaj, t'ia

paguaj shumën prej 1,549.80 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 27.07.2021 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përbarimit të detyrueshëm”.

VI. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses B.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 4,563.54 euro e deri në shumën prej 4,572.18 euro dhe atë për shumën prej 8.64 euro.

VII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit P.M për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 1,549.80 euro e deri në shumën prej 2,988.90 euro dhe atë për shumën prej 1,439.10 euro.

VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve B.K, M.K dhe P.M, t’ia paguajë shumën prej 309.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit B.K, M.K dhe P.M, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 27.07.2021, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 10,549.98 euro.

Të njëjti sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Sadedin Hajda”, në Rahovec. Me parashtrësën e datës 02.02.2023 kanë precizuar kërkesëpadinë ku në bazë të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr.01/33, dhe nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, u takon e drejta e kompensimit në emër të të ardhurave personale në emër të stimulimit për kualifikim, përkatësisht me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet prej 27%. Andaj i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 23.03.2023, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Duke shtuar se e paditura i ka kryer obligimet në kuptim të nenit 7 të KKAK-së, në atë mënyrë që paditësi është paguar në emër të kualifikimit. Sa i përket Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021 MASHTI ka shkëputur këtë kontratë me SBASHK. MASHTI me këtë rast ka theksuar se shkëput kontratën njëanshëm bazuar në kornizën ligjore në fuqi, pasi e njëjta është nënshkruar në mungesë të bazës ligjore. Paditësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është

parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës e datës 01.10.2017 dhe datës 02.09.2019, të lidhura ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses B.K; diplomën me numër 1365 e datës 25.11.2016 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës; licencën e mësimdhënësit Nr. 10266120; kontratën e punës për mësimdhënës e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses M.K; diplomën me numër 602 e datës 30.08.2012 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës; licencën e mësimdhënësit Nr. 100024380; kontratat e punës për mësimdhënës e datës 01.9.2020 dhe datës 30.04.2021, të lidhura ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit P.M; diplomën me numër 000216444 e datës 31.12.2019 e lëshuar nga Universiteti i Arteve – Republika e Shqipërisë; licencën e mësimdhënësit Nr. 10029136 dhe listën e pagave të muajit qershor 2021.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit posedojnë licencë të mësimdhënësit. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe kualifikimit dhe a është kërkesa e parashkruar.

Me administrimin e kontratave të punës për mësimdhënës ë datës 01.10.2017 dhe datës 02.09.2019 të lidhura ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses B.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Faik Sylka” në Rahovec.

Me administrimin e diplomës me numër 1365 e datës 25.11.2016 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve në Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.K, ka përfunduar Fakultetin e Arteve më datën 03.10.2016 dhe mori titullin Bachelor i Pianos.

Me administrimin e licencën e mësimdhënësit Nr. 1026612, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.K posedon licencë të llojit “Licencë e Karrierës”.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses M.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në Shkollën e Muzikës në Rahovec.

Me administrimin e diplomës me numër 602 e datës 30.08.2012 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve në Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M.K ka përfunduar Fakultetin e Arteve më datën 10.07.2012 dhe mori titullin Bachelor i Klarinentit.

Me administrimin e licencën e mësimdhënësit Nr. 100024380, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M.K posedon licencë të llojit “Licencë e Karrierës”.

Me administrimin e kontratave të punës për mësimdhënës 02.09.2019 dhe të datës 30.04.2021 të lidhura ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit P.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe njëjta është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Faik Sylka” në Rahovec.

Me administrimin e diplomës me numër 000216444 e datës 31.12.2019 e lëshuar nga Universiteti i Arteve- Republika e Shqipërisë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi P.M ka përfunduar Fakultetin e Arteve më datën 03.07.2019 dhe mori titullin Bachelor në Programin Koreografi.

Me administrimin e licencën e mësimdhënësit Nr. 1029136, gjykata vërtetoi faktin se paditësi P.M posedon licencë të llojit “Licencë e Karrierës”.

Me administrimin e listës së pagave për muajin qershor 2021, gjykata vërtetoi faktin se në muajin qershor të vitit 2021, paditësit në këtë periudhë kishin pagën bazë prej 421 euro, ndërsa në emër të kualifikimit paditësve M.K dhe P.M iu është paguar shuma prej 58.32 euro, ndërsa paditëses B.K në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 29.16 euro.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësve për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1. të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës. Në këtë rast paditëseve në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedojnë diplomë të nivelit Bachelor iu ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 27%. Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve M.K dhe P.M, iu ka paguar shumën prej 58.32 euro, ndërsa paditëses

B.K në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, i ka paguar shumën prej 29.16 euro. Sipas pikës 4 nën pikën 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja B.K përfitoi ngritje prej 27% të pagës bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 84.51 euro, ndërsa paditësit M.K dhe P.M përfituan ngritje prej 27% të pagës bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 55.35 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën III. IV. dhe V. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t'i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parashihet *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses B.K në pjesën tjetër në shumën prej 8.64 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 në pikën 4 nën pikën 2, dhe listës së pagave si dhe sipas përlllogaritjes së gjykatës paditëses i takon kompensimi si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Po ashtu gjykata vendosi ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit P.M në pjesën tjetër të kërkesëpadisë për periudhën kohore prej datës 01.07.2018 deri me datën 31.08.2020, në shumën prej 1,439.10 euro, pasi që është vërtetuar fakti se paditësi P.M ka diplomuar në Universitetin e Arteve – Republika e Shqipërisë me datën 03.07.2019, ndërsa ka themeluar marrëdhënien e punës pranë të paditurës nga data 01.09.2020. Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë që përfshin periudhën kohore nga data 01.07.2018 deri me 31.08.2020, pasi që paditësi gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës, andaj të njëjtit nuk i takon kompensimin në emër të kualifikimit apo licencimit.

Përveç kësaj gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës që përfshin periudhën prej datës 18.04.2017 e deri me datë 31.06.2018. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 19.07.2021.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit*

meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi pjesërisht pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”,* në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë paditësve shumën si në pikën VII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 309.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 208.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 101.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.764/2021, më datë 20.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.